



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

"HASAN PRISHTINA"

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 73/1 Prishtinë 12-01 2023

## PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

### DEPARTAMENTI KONTRUKTIV

Studenti **Hamëz Deliu** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: "Trajtimii i urave nga ngarkesat sizmike,rasti i urave të parafabrikuara " në programin e studimeve Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

### Abstrakt

Kosova si shtet bën pjesë në kontinentin e Evropës edhe pse është pjesë e kontinentit Evropian ajo nuk është anëtare e Komitetit Evropian për Standardizim. Megjithatë, ka interesa nga ana e institucioneve të Kosovës t'i përfshijë kodet Evropiane si norma shtetërore të ndërtimit në Kosovë. Për shkak të kësaj, besohet që në një të ardhme të afërt Kosova të kalojë në Standardet Evropiane.

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i performancës sizmike për sistem të urave të parafabrikuara në mbarë botën e në veçanti në Kosovë. Performaca e urave që janë vëzhguar nga tërmetet e kaluara, si Loma Prieta e vitit 1989, Hanshin i vitit 1995, Kumamoto i vitit 2016, Northridge i vitit 1994, Jiji i vitit 1999, Taitung i vitit 2022 etj., kanë treguar se urat janë të ndieshme nga tërmetet, duke i dëmtuar ato dhe duke ju humbur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Ura, një strukturë që krijon lidhje midis pjesëve të ndryshme të shkëputura të një vendi, dy brigjeve ose pjesëve të dy vendeve. Për projektim të urës së parafabrikuar mirren parasysh ndikimet që shkaktohen në urë, kryesisht ngarkesa nga sizmika. Duke u bazuar në EC-8-1 e në veçanti EC-8-2 dhe mirren parasysh këto ndikimet kryesore: ngarkesat themelore, ngarkesat plotësuese dhe ngarkesat e veçanta (ku bën pjesë sizmika).

Për projektim të urës së parafabrikuar nga EC-8-2 janë marrë parasysh këto aspekte: gjendjet kufitare ULS dhe SLS, llojet strukturore, klasat e rëndësisë, zonat sizmike, sjellja sizmike e strukturave, tipet e trojeve, shuarja, spektri elastik dhe i projektimit, faktori i sjelljes, klasat e rëndësisë, ndryshueshmëria hapësinore e veprimit sizmik, kombinimet modale dhe komponentëve sizmik, analiza pushover, efektet e projektimit të kapacitetit, kombinimi i veprimit sizmik me veprime të tjera, kapaciteti sizmik deformues i shtyllave-zhvendosja përfundimtare, lakimi përfundimtar, këndi i rrotullimit.

Struktura e urës së parafabrikuar analizohet dhe shyrtohet me anë të programit MIDAS Civil, nga i cili pritët të fitohen rezultatet që plotësohen kushtet e e nevojshme për ta bërë strukturën të ketë stabilitet dhe qëndrueshmëri të nevojshme nga ngarkesa e sizmikës.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.